REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. ....15.................. Prot                                        Tiranë, më 25/ 02/ 2022
*Lutemi referoni këtë numër në përgjigje*

**VENDIM**
Nr.03, date 25 /02/2022

**PËR**

**PROJEKTIN E ZBATIMIT PER UDHEZUESIT E PORTAVE TE MIREMBAJTJES NE DIGEN E QYRSAQIT**

Në mbështetje te Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytezimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 25.02.2022 mori në shqyrtim projektin e zbatimit për Udhëzuesit e Portave të Mirembajtjes në digën e Qyrsaqit i paraqitur nga shfrytëzuesi i Digës, Korporata Elektroenergjitike Shqiptare. Projekti i Zbatimit është pregatitur nga kompania ANDRITZ dhe i aprovuar nga firma Konsulente FICHTNER. Bazuar në dokumentacionin teknik të paraqitur dhe pas diskutimeve të të gjithë antareve të pranishëm, KKDM

**VENDOSI:**

1- Të miratojë Projektin e Zbatimit për Udhëzuesit e Portave të Mirëmbajtjes në digën e Qyrsaqit të paraqitur nga KESH sha

2- Ti kërkojë KESH Sha

- Të paraqesë brenda muajit Mars 2022 programin e punës për zbatimin e këtij projekt zbatimi
- Të paraqesë për miratim në KKDM, mbikqyresin e punimeve të emëruar prej KESH në përputhje me kërkesat e nenit 20 të VKM Nr.147, dt.18.03.2004.
- Të informojë cdo 6 muaj në KKDM për ecurinë e punimeve të zbatimit të projektit, problematikat që mund të hasen si dhe zgjidhjet përkatëse

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**